



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 1128

Prishtinë, Dt. 04/06/2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	i Shkencave Matematike Natyrore
Departamenti/ Programi	i Gjeografisë
Projektpropozimi	Shqyrtime rreth nivelit të arsimimit dhe punësimit të grave në Kosovë në dhjetë-vjejarin e fundit, 2014-2024
Kandidati	Arjanita Haradini
Mentori	Prof. Asoc. Dr. Mimoza Dushi
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 04.10.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 4096
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Kandidatja Arjanita Haradini, studente në programin master të Gjeografisë, pas përfundimit të suksesshëm të provimeve dhe përmbushjes së obligimeve të tjera të parashikuara me rregullore, ka fituar të drejtën të punojë në temën e diplomës me titull: "Shqyrtime rreth nivelit të arsimit dhe punësimit të grave në Kosovë në dhjetëvjeçarin e fundit, 2014–2024".</p> <p>Punimi është i strukturuar në nëntë kapituj tematikë dhe trajton me seriozitet e kujdes një temë me rëndësi të veçantë shoqërore dhe demografike. Qasja metodologjike është ndërtuar mbi metoda krahasuese, analitike dhe statistikore, ndërsa të dhënat bazohen kryesisht në burime zyrtare si Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Anketa e Fuqisë Punëtore, si dhe në burime të përzgjedhura të literaturës akademike.</p> <p>Në kapitujt hyrës, kandidatja ka formuluar në mënyrë të qartë qëllimin e studimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat, duke ndërtuar bazën teorike të hulumtimit. Ajo e ka përqendruar analizën në marrëdhënien ndërmjet arsimimit dhe përfshirjes së grave në tregun e punës, si faktorë të ndërlidhur në përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri.</p> <p>Në pjesën e tretë të punimit, trajtohet konteksti historik dhe shoqëror i pozitës së gruas në shoqërinë tradicionale shqiptare në Kosovë. Kandidatja paraqet një analizë të thelluar të ndikimit të normave patriarkale dhe të rolit të Kanunit në përjashtimin e grave nga sfera publike, duke</p>

krijuar një lidhje të qëndrueshme ndërmjet strukturave sociale dhe statusit të ulët të grave në të kaluarën.

Më tej, në kapitullin që trajton zhvillimet ekonomike dhe sociale pas Luftës së Dytë Botërore, kandidatja përshkruan me kujdes proceset e industrializimit të lehtë dhe përpjekjet e pasluftës për përfshirjen e grave në arsim dhe ekonomi. Ajo argumenton se përmirësimi i kushteve ekonomike dhe reformat arsimore kishin ndikim pozitiv në fuqizimin e gruas, ndonëse këto ndryshime ndodhën me ngadalësi dhe u përballën me pengesa të vazhdueshme.

Në pjesën që fokusohet në përfshirjen e grave në nivelet e arsimit, përshkruhet rruga historike e shkollimit të grave në Kosovë, duke filluar nga vitet e para të pasluftës deri në hapjen e Universitetit të Prishtinës dhe më tej. Kandidatja trajton me qartësi pengesat strukturore dhe kulturore që kanë ndikuar në përqindjen e ulët të përfshirjes së grave në arsimin e mesëm dhe të lartë, veçanërisht në zonat rurale. Në analizën e periudhës 2014–2024, ajo vë në pah rritjen graduale të përfshirjes së grave në arsimin universitar, me një rritje të përqindjes nga 52.9% në 2014 në 55.1% në 2024, duke argumentuar se kjo pasqyron një trend pozitiv në zhvillimin e potencialit të grave për pjesëmarrje më aktive në shoqëri.

Kapitulli për punësimin e grave paraqet të dhëna relevante për përfshirjen e tyre në tregun e punës gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Kandidatja konstaton një përmirësim të dukshëm, me rritje nga 12.5% në vitin 2014 në 21.1% në vitin 2024. Megjithatë, ajo argumenton me të drejtë se këto shifra mbeten të ulëta në krahasim me vendet evropiane dhe se përfshirja e grave është kryesisht e përqendruar në sektorë si shëndetësia, arsimi dhe tregtia, ndërkohë që mungon prezenca e tyre në profesione teknike dhe pozita drejtuese. Kandidatja e lidh këtë fenomen me mungesën e orientimit në karrierë, stereotipat gjinore dhe tregun e kufizuar të punës në vend.

Në kapitullin që trajton ndryshimet aktuale të pozitës së gruas, punimi paraqet të dhëna nga pyetëtori i realizuar, i cili dëshmon se gratë e punësuar raportojnë kushte më të mira ekonomike dhe përfshirje më të madhe në vendimmarrje. Vlerësohet se përfshirja në arsim dhe punësim ka ndikuar pozitivisht në fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grave. Sidoqoftë, sfidat si nepotizmi, mungesa e meritokracisë dhe barrierat strukturore mbeten të theksuara.

Në përfundim, kandidatja përmbledh të gjitha gjetjet kryesore të punimit, duke theksuar se fuqizimi i grave përmes arsimit dhe punësimit është një nga shtyllat themelore të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik. Ajo ofron rekomandime për forcimin e mbështetjes institucionale, zbatimin e politikave për barazi gjinore dhe promovimin e grave në sektorë ku ato janë nënperfaqësuar.

Punimi i diplomës së Arjanita Haradinit është i ndërtuar në mënyrë të qëndrueshme dhe mbështetet në të dhëna relevante e literaturë shkencore. Kandidatja dëshmon aftësi të qarta për analizë teorike dhe empirike, shprehje akademike të saktë dhe qasje serioze kërkimore. Struktura e punimit është e qartë, përmbajtja e qëndrueshme dhe përfundimet janë në përputhje me qëllimin e deklaruar.


Në mbështetje të këtij vlerësimi, Komisioni për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së diplomës master te titull “Shqyrtime rreth nivelit të arsimit dhe punësimit të grave në Kosovë në dhjetëvjeçarin e fundit, 2014–2024” të kandidatës Arjanita Haradini, ka marrë parasyh të gjitha vështirësitë që e përcjellin punën kërkimore e empirike dhe paraqet këtë

P R O P O Z I M

Departamentit të Gjeografisë dhe të instancave përkatëse të Fakultetit Shkencave Matematike-Natyrore që tema e masterit "Shqyrtime rreth nivelit të arsimit dhe punësimit të grave në Kosovë në dhjetëvjeçarin e fundit, 2014–2024" e kandidatës Arjanita Haradini, i plotëson kushtet profesionalo-shkencore dhe ligjore që të procedohet për mbrojtje publike dhe kandidatja të fitojë titullin e masterit të shkencave gjeografike.

Prishtinë, 04.06.2025


Komisioni:



Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli, kryetar



Prof. Asoc. Dr. Mimoza Dushi, anëtar



Prof. Asoc. Dr. Shpejtim Bulliqi, anëtar